



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18), nenit 57, paragrafi (2) dhe paragrafi (3) dhe nenit 59, paragrafi (5) të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16 dhe 7/19), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, miratoi

V E N D I M

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për dhënien e pëlqimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 50/19)

1. Në vendimin për dhënien e pëlqimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/13 dhe 24/18) fjalët: "Republika e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "Republika e Maqedonisë së Veriut", përveç në pikat 59) dhe 61) të Vendimit për dhënien e pëlqimeve.
2. Në pikën 16), nënpika 16.11.), paragrafi (1) ndryshohet dhe bëhet: "Banka Popullore sipas detyrës zyrtare ofron vërtetim për (mos)gjykim të anëtarit të propozuar, në kuptim të nenit 83, paragrafi (3) të Ligjit të Bankave, nga gjykata kompetente". Nëse personi i cili është propozuar për anëtar të këshillit mbikëqyrës është person i huaj, është i detyruar vetë të sigurojë vërtetim të tillë nga institucionet kompetente në vendin e huaj.
3. Në pikën 19), paragrafi (3), pika në nënparagrafin (4) zëvendësohet me pikë dhe presje dhe shtohet nënparagraf i ri (5), i cila bëhet:
"- gjykimi i tij në kuptim të nenit 83, paragrafi (3) të Ligjit të Bankave".
4. Në pikën 21), nënpika 21.12,) pika 28), paragrafi (1), nënparagrafi (2) dhe pika 3.1) nga formulari 2, fjalët: "neni 83, paragrafi (6)" zëvendësohen me fjalët: "neni 83, paragrafi (8)".
5. Në pikën 21), pas nënpikës 21.14), shtohet nënpika e re 21.15.), që thotë:
"21.15. Deklarata e personit të propozuar për anëtar të bordit drejtues, e dhënë me përgjegjësi të plotë penale dhe materiale, së bashku me person tjetër fizik, direkt ose indirekt dhe/ose përmes marrëveshjes, realizon kontroll mbi shoqëri tregtare vendase ose të huaj.

Në nënpikën 21.15.) e cila bëhet nënpika 21.16.), paragrafi (1) ndryshohet dhe thotë:

“Banka Popullore, sipas detyrës zyrtare, siguron vërtetim për (mos) gjykimin e anëtarit të propozuar, në kuptim të nenit 83, paragrafi (3) të Ligjit të Bankave, nga gjykata kompetente. Nëse anëtari i propozuar ka bashkëpunëtor në kuptim të Ligjit të Bankave, Banka Popullore sipas detyrës zyrtare siguron vërtetim për (mos)gjykimin e bashkëpunëtorit nga gjykata kompetente. Nëse bëhet fjalë për persona të huaj, vërtetimet e tilla të lëshuara nga institucionet kompetente në shtetin e huaj duhet të dorëzohen me kërkesën për dhënien e pëlqimit.

Nënpika 21.16.) bëhet nënpika 21.17).

6. Në pikën 23, paragrafi (1), pas kllapës pas fjalës: “mbikëqyrje” shtohet presje dhe fjalët; “dhe 21.15” zëvendësohen me fjalët: “21.15. dhe 21.16”.

7. Në pikën 25, paragrafi (4), pika në nënparagrafin (4) zëvendësohet me pikë dhe presje dhe shtohet nënparagraf i ri (5), që thotë:

“- gjykimi i tij, duke përfshirë gjykimin e bashkëpunëtorit, nëse ka, në kuptim të nenit 83, paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit të Bankave”.

8. Në pikën 51, paragrafi (1), nënparagrafi (4) ndryshohet dhe thotë:

“-reputacioni i personit që synon të fiton aksione në bankë. Për personin që ka për qëllim të marr aksione në bankë do të konsiderohet se ka reputacion të duhur nëse është e drejtë, kompetente, punëtor dhe jep siguri se me punën e vet nuk do të rrezikon stabilitetin dhe sigurinë e bankës dhe nuk do të shkel reputacionin dhe besimin e saj.

Kjo nënkupton se për këtë person nuk ka dëshmi për përfshirjen e tij të mëparshme në veprimtari afariste ose aktivitete që nënkuptojnë mosrespektim të rregulloreve dhe praktikave dhe procedurat afariste, shkelje apo kërcënim për interesat e personit juridik ku ka punuar ose punon dhe interesat e kreditorëve të tij, bashkëpunimi i papërshtatshëm ose refuzimi për të bashkëpunuar me autoritetet kompetente, duke përfshirë autoritetet mbikëqyrëse, refuzimin, revokimin ose tërheqjen e pëlqimit të aksionarëve nga organi mbikëqyrës kompetent. Reputacioni adekuat nënkupton edhe vërtetimin për mosgjykim nganeni 13, paragrafi (3) i Ligjit të Bankave, duke përfshirë edhe mosgjykim të bashkëpunëtorit të personit fizik i cili synon të fiton aksione në bankë;”.

9. Në formularët 1, 2, 3 dhe 5, pika 5) ndryshohet dhe thotë:

“5. A keni qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë me dënim me burg të pakushtëzuar mbi gjashtë muaj? Nëse është shqiptuar aktgjykim i tillë, theksoni të gjitha detajet”.

10. Në formularët 2 dhe 3, pas pikës 5) shtohet pikë e re 5.1.) që thotë:

"5.1. Nëse keni bashkëpunëtor në kuptim të Ligjit të Bankave, a është dënuar me aktgjykim të formës së prerë me burgim të pakushtëzuar mbi gjashtë muaj? Nëse është shqiptuar dënim i tillë, theksoni të gjitha detajet".

11. Në formularin 4, pika 12) ndryshohet dhe bëhet:

"12. A është dënuar me aktgjykim të formës së prerë (nëse është person fizik) personi që ushtron kontroll në personin juridik me burgim të pakushtëzuar mbi gjashtë muaj? Nëse është shqiptuar dënim i tillë, theksoni të gjitha detajet".

12. Në procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/19), do të zbatohen dispozitat e Vendimit për dhënien e pëlqimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/13 dhe 24/18).

13. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V nr. 02-15/II-5/2019
28 shkurt 2019
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
i këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска